



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr.196 , datë 26.3.2026

P Ë R

**PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE PËR ORGANIZIMIN,
FUNKSIONIMIN DHE PËRBËRJEN E KOMISIONIT
TË VLERËSIMIT, SI DHE TË KRITEREVE, PROCEDURAVE
TË PËRZGJEDHJES E TË SHPËRBLIMIT TË ANËTARËVE TË TIJ**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 15, të ligjit nr.75/2019, “Për rininë”, i ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

I. DISPOZITA TË PËRGGJITHSHME

1. Komisioni i Vlerësimit, në vijim “komisioni”, ngrihet për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për mbështetje përmes fondeve grant të buxhetit të shtetit, të dedikuara për rininë, të paraqitura nga organizatat rinore dhe/ose për të rinjtë, bashkitë, grupet joformale rinore dhe këshillat rinorë vendorë, në kuadër të thirrjeve publike të Agjencisë Kombëtare të Rinisë (në vijim “AKR”).
2. Ky vendim ka si objekt përcaktimin e përbërjes, rregullave të organizimit, funksionimit dhe detyrave të komisionit të vlerësimit për thirrjet, si dhe përcaktimin e kriterëve, procedurës së përzgjedhjes, rasteve të mbarimit të mandatit e të lirimimit nga detyra të anëtarëve, si dhe të masës së shpërblimit financiar të tyre.

**II. PËRBËRJA E KOMISIONIT TË VLERËSIMIT, KRITERET DHE
PROCEDURA E PËRZGJEDHJES SË ANËTARËVE**

1. Për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për mbështetje përmes fondeve grant të buxhetit të shtetit, të dedikuara për rininë, ngrihet komisioni i

vlerësimet me përbërje të posaçme, në bazë të thirrjes publike të shpallur nga AKR-ja.

- a) Komisioni i vlerësimit, i ngritur për të vlerësuar thirrjet për organizatat rinore dhe/ose për të rinjtë, përbëhet nga:
 - i. 1 (një) anëtar i caktuar nga ministri përgjegjës për rininë, në rolin e kryetarit të komisionit;
 - ii. 2 (dy) anëtarë të caktuar nga titullari i AKR-së;
 - iii. 2 (dy) anëtarë ekspertë nga shoqëria civile, me përvojë në vlerësimin e projekteve zhvillimore apo me ndikim të rinjtë e përzgjedhur nga AKR-ja, sipas procedurës së parashikuar në këtë vendim.
 - b) Komisioni i vlerësimit, i ngritur për të vlerësuar thirrjet për bashkitë, përbëhet nga:
 - i. 1 (një) anëtar i caktuar nga ministri përgjegjës për rininë, në rolin e kryetarit të komisionit;
 - ii. 1 (një) anëtar i caktuar nga titullari i AKR-së;
 - iii. 1 (një) anëtar ekspert, me profil inxhinier civil dhe me përvojë në zbatimin dhe/ose supervizimin e projekteve të vogla infrastrukturore.
 - c) Komisioni i vlerësimit, i ngritur për të vlerësuar thirrjet për grupe joformale rinore dhe këshillat rinorë vendorë, përbëhet nga 3 (tre) anëtarë, të emëruar nga titullari i AKR-së.
2. Anëtarët e komisionit të vlerësimit, të parashikuar në shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 1, të këtij kreu, miratohen nga ministri përgjegjës për rininë.
 3. Anëtari i komisionit të vlerësimit, sipas parashikimeve në nënndarjet “i” dhe “ii”, shkronja “a”, dhe në nënndarjet “i” dhe “ii”, shkronja “b”, të pikës 1, duhet të plotësojë kushtet dhe kriteret e mëposhtme:
 - a) Të jetë nëpunës i administratës shtetërore;
 - b) Të ketë si pjesë të detyrave funksionale hartimin, zbatimin ose monitorimin e politikave, programeve dhe/ose projekteve për rininë;
 - c) Të ketë jo më pak se 2 (dy) vjet përvojë pune në fushën e rinisë ose të ushtrisë funksion drejtues në institucionin përgjegjës për zbatimin e politikave rinore.
 4. Anëtari, ekspert i komisionit të vlerësimit, i përcaktuar në nënndarjen “iii”, të shkronjës “a”, të pikës 1, të këtij kreu, duhet të plotësojë kushtet dhe kriteret e mëposhtme:

- a) Të ketë mbaruar studimet universitare të ciklit të dytë (“Master i Shkencave” ose ekuivalent), për drejtësi, administrim publik, shkenca ekonomike apo shkenca shoqërore;
 - b) Të mos jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë;
 - c) Të ketë mbi 10 (dhjetë) vjet përvojë pune në fushën e politikave sociale dhe rinore;
 - ç) Të ketë përvojë të mëparshme në vlerësimin e propozimeve të organizatave të shoqërisë civile në kuadër të thirrjeve konkurruese për financim;
 - d) Të ketë përvojë në përgatitjen, zbatimin, monitorimin dhe/ose vlerësimin e projekteve të financuara me fonde publike;
 - dh) Të ketë njohuri në fushën e politikave dhe çështjeve rinore.
5. Anëtari, ekspert i komisionit të vlerësimit, i përcaktuar në nënndarjen “iii”, të shkronjës “b”, të pikës 1, të këtij kreu, duhet të plotësojë kushtet e kriteret e mëposhtme:
- a) Të ketë mbaruar studimet universitare të ciklit të dytë (“Master i Shkencave” ose ekuivalent), për inxhinieri civile;
 - b) Të mos jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë;
 - c) Të ketë mbi 10 (dhjetë) vjet përvojë pune;
 - ç) Të ketë përvojë në projektimin, zbatimin dhe/ose supervizimin e projekteve infrastrukturore të financuara me fonde publike.
6. Anëtari i komisionit të vlerësimit, sipas parashikimeve të shkronjës “c”, të pikës 1, duhet të plotësojë kushtet dhe kriteret e mëposhtme:
- a) Të jetë nëpunës i Agjencisë Kombëtare të Rinisë;
 - b) Të ketë si pjesë të detyrave funksionale hartimin, zbatimin ose monitorimin e politikave, programeve dhe/ose projekteve për rininë;
 - c) Të ketë jo më pak se 2 (dy) vjet përvojë pune në fushën e rinisë.
7. Anëtari, ekspert i komisionit të vlerësimit, i parashikuar në shkronjat “a”, nënndarja “iii”, dhe “b”, nënndarja “iii”, të pikës 1, të këtij kreu, përzgjidhet mbi bazën e një procesi të hapur konkurrimi.
8. AKR-ja harton termat e referencës dhe shpall thirrjen e konkurrimit për ekspertët, brenda 7 (shtatë) ditëve kalendarike nga shpallja e thirrjes publike për mbështetje përmes fondeve grant të buxhetit të shtetit, të dedikuara për rininë. Thirrja publikohet në faqen e internetit të institucionit dhe qëndron e hapur për të paktën 10 (dhjetë) ditë.

9. Kandidati për pozicionin e ekspertit në komisionin e vlerësimit dorëzon në rrugë elektronike pranë AKR-së dokumentacionin, si më poshtë vijon:

- a) Jetëshkrimin;
- b) Kopje të dokumentit të identifikimit;
- c) Letërmotivimin;
- ç) Vetëdeklarimin për vërtetësinë e të dhënave;
- d) Kopjen e diplomës universitare;
- dh) Dëshminë e penalitetit.

10. AKR-ja bën shqyrtimin dhe vlerësimin e dokumentacionit të kandidatëve dhe, brenda 5 (pesë) ditëve nga përfundimi i thirrjes së konkurrimit për ekspertë, sipas rastit, shpall fitues:

- a) 2 (dy) kandidatët e vlerësuar me pikët më të larta, në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit, të parashikuar në nënndarjen “iii”, të shkronjës “a”, të pikës 1, të këtij kreu. Në rastin e krijimit të vakancës, ekspertët e parë zëvendësohen nga 2 (dy) kandidatët e renditur menjëherë pas tyre.
- b) kandidatin e vlerësuar me pikët më të larta, në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të përcaktuar në nënndarjen “iii”, të shkronjës “b”, të pikës 1, të këtij kreu. Në rast të krijimit të vakancës, eksperti i parë zëvendësohet nga një 1 (një) kandidat i renditur menjëherë pas tij.

III. ORGANIZIMI, FUNKSIONIMI DHE DETYRAT E KOMISIONIT TË VLERËSIMIT, RASTET E MBARIMIT TË MANDATIT DHE TË LIRIMIT NGA DETYRA TË ANËTARËVE

1. Mbledhjet e komisionit të vlerësimit zhvillohen pranë AKR-së.
2. Komisioni i vlerësimit mbështetet në punën e tij nga sekretariati teknik, i përbërë nga 2 (dy) anëtarë, të emëruar nga titullari i AKR-së.
3. Mbledhjet thirren dhe drejtohen nga kryetari i komisionit të vlerësimit. Në mungesë të kryetarit, me delegim të tij, mbledhja drejtohet nga një anëtar tjetër i komisionit të vlerësimit.
4. Sekretariati teknik njofton anëtarët e komisionit të vlerësimit, të paktën 2 (dy) ditë përpara datës së caktuar për mbledhjen.
5. Komisioni i vlerësimit mbledhet në mbledhjen e parë, jo më vonë se 5 (pesë) ditë kalendrike pas mbylljes së thirrjes publike të AKR-së. Gjatë kësaj mbledhjeje, me propozim të kryetarit dhe me shumicën e votave të anëtarëve të tij, miratohet kalendari i punës së komisionit të vlerësimit.

6. Anëtarët e komisionit të vlerësimit dhe sekretariatit teknik nënshkruajnë një deklaratë për parandalimin e konfliktit të interesit dhe konfidencialitetit, përpara fillimit të ushtrimit të detyrës.
7. Sekretariati teknik administron aplikimet e kandidatëve në thirrjen publike, së bashku me dokumentacionin shoqërues dhe i vendos në dispozicion të anëtarëve të komisionit të vlerësimit.
8. Komisioni i vlerësimit ushtron këto detyra dhe kompetenca:
 - a) Shqyrton dhe vlerëson çdo projektpropozim të dorëzuar në thirrjen konkurruese të AKR-së, bazuar në kriteret, procedurat, dokumentacionin dhe afatet e thirrjes publike dhe parashikimet e vendimit nr.566, datë 29.7.2022 të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave të përzgjedhjes së organizatave rinore dhe organizatave për të rinjtë, që përfitojnë financime nga fondet grant nga buxheti i shtetit, të dedikuara për rininë”, i ndryshuar.
 - b) Plotëson formularët e vlerësimit për çdo projektpropozim të dorëzuar ku anëtarët e tij japin pikët individuale;
 - c) Përgatit renditjen paraprake të projektpropozimeve bazuar në pikëzimin dhe vendimmarrjen e të gjithë anëtarëve dhe, sipas rastit, përgatit rekomandimet për rishikim të projektpropozimeve individuale, me qëllim përmirësimin e tyre;
 - ç) Harton e nënshkruan procesverbalin e vlerësimit të projektpropozimeve dhe listën e projekteve të përzgjedhura për financim.
9. Komisioni, në përfundim të procesit të vlerësimit, harton procesverbalin e vlerësimit të projektpropozimeve të dorëzuara nga kandidatët në thirrjen konkurruese të AKR-së. Procesverbali përmban renditjen e projektpropozimeve të shqyrtuara bazuar në pikëzimin e të gjithë anëtarëve të komisionit, vendimmarrjen e arsyetuar për çdo projektpropozim, rekomandimet për rishikim të një projektpropozimi të përzgjedhur me kusht për financim dhe informacionin për projektet e skualifikuara për mungesë dokumentacioni. Procesverbali nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e komisionit dhe administrohet nga AKR-ja.
10. Procesverbali i vlerësimit, nëpërmjet AKR-së, i dërgohet brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike për miratim ministrit përgjegjës për rininë.
11. Mandati i anëtarit të komisionit të vlerësimit fillon me aktin e emërimit dhe përfundon me përfundimin e plotë të procedurës së vlerësimit për thirrjen publike përkatëse, përfshirë miratimin e listës përfundimtare të projekteve të përzgjedhura për financim.

12. Mandati i anëtarit të komisionit të vlerësimit mbaron në rastet e mëposhtme:
- a) Jep dorëheqjen;
 - b) Humbet zotësinë juridike për të vepruar me vendim gjykate;
 - c) Dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë;
 - ç) Me vdekjen e anëtarit;
 - d) Përfundon mandati i qëndrimit në detyrë;
 - dh) Lirohet nga detyra.
13. Anëtari i komisionit të vlerësimit lirohet nga detyra, para përfundimit të mandatit, në rastet e mëposhtme:
- a) Ndërpret marrëdhënien e punës me institucionin që përfaqëson;
 - b) Me veprimet e tij dëmton veprimtarinë e komisionit të vlerësimit dhe imazhin e institucioneve përgjegjëse për funksionimin e këtij komisioni;
 - c) Nuk përmbush detyrat si anëtar i komisionit të vlerësimit;
 - ç) Nuk merr pjesë në 2 (dy) mbledhje radhazi të komisionit pa shkak të arsyeshëm dhe nuk ka njoftuar paraprakisht kryetarin.
14. Pozicioni i anëtarit të komisionit të vlerësimit, i mbetur vakant për shkak të rasteve të mbarimit të mandatit apo lirimit nga detyra e anëtarit, plotësohet brenda 5 (pesë) ditësh kalendarike nga krijimi i vakancës, sipas procedurës së ndjekur për emërimin e anëtarit të larguar.
15. Kohëzgjatja e mandatit të anëtarit zëvendësues është sa pjesa e mbetur e mandatit të anëtarit të larguar.

IV. MASA E SHPËRBLIMIT

1. Kryetari dhe anëtarët e komisionit të vlerësimit të thirrjeve përfitojnë shpërblim financiar për vlerësimin e dosjeve aplikuese.
2. Shpërblimi llogaritet në masën 800 (tetëqind) lekë për çdo dosje aplikimi nga organizatat rinore dhe/ose për të rinjtë dhe bashkitë, të vlerësuar nga anëtari përkatës, dhe 280 (dyqind e tetëdhjetë) lekë për çdo dosje aplikimi nga grupet rinore joformale, të vlerësuar nga anëtari përkatës.
3. Shpërblimi llogaritet sipas numrit real të dosjeve të vlerësuar, të vërtetuar në procesverbalin e komisionit.
4. Shpërblimi paguhet nga buxheti i Agjencisë Kombëtare të Rinisë.

V. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Funksionimi i komisionit të vlerësimit u nënshtrohet rregullave të parashikuara në legjislacionin për organet kolegjiale të administratës shtetërore për çështjet që nuk janë të rregulluara posaçërisht në këtë vendim.
2. Në vendimin nr.566 datë 29.7.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave të përzgjedhjes së organizatave rinore dhe organizatave për të rinjtë, që përfitojnë financime nga fondet grant nga buxheti i shtetit, të dedikuara për rininë”, i ndryshuar, shkronja “d” e nenit 2, dhe nenet 13, 14 e 15 shfuqizohen.
3. Ngarkohen ministria përgjegjëse për rininë dhe Agjencia Kombëtare e Rinisë (AKR) për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

**MINISTRI I TURIZMIT,
KULTURËS DHE SPORTIT**

BLENDI GONXHJA

NR.PROT. 1699/1
DATË 26.3 .2026

MINISTRISË SË TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT
AGJENCISË KOMBËTARE TË RINISË
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Elsonida RAMA

